

VENDIM
Nr.620, datë 21.12.1999

**PËR MIRATIMIN, NË PARIM, TË MARRËVESHJES NDËRMJET QEVERISË SË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË
GJERMANISË PËR PROJEKTIN “MBËSHTETJA E INSTITUCIONEVE TË VETNDIHMËS
TË BUJQËSISË PRIVATE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 7, të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998, “Për lidhjen e traktateve dhe të marrëveshjeve ndërkombëtare” me propozimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit dhe Ministrisë së Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin, në parim të marrëveshjes ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për projektin “Mbështetja e institucioneve të vetndihmës të bujqësisë private” me një fond grant prej 1.93 milion DM.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta